



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 67, datë 26.03.2021

**PËR UDHËZIMET E PËRBASHKËTA MIDIS MINISTRIT TË BRENDSHËM,
MINISTRIT TË DREJTËSISË DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË.**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 157, pika 2, germa ç, 159, pika 1, 189, pika 1, germa “c”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28, të Ligjit nr.10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për Udhëzimet e Përbashkëta midis Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë udhëzimet sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - a) Udhëzimi “Për kushtet, rregullat, procedurat dhe mënyrat e zbatimit të programit të mbrojtjes, kriteret dhe procedurat për ruajtjen, administrimin dhe klasifikimin e informacionit për programin e mbrojtjes”.
 - b) Udhëzimi “Për rregullat dhe procedurat e zbatimit të programit të mbrojtjes së bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
 - c) Udhëzimi “Për rregullat e hollësishme, për detyrat, përgjegjësitë, format dhe procedurat e bashkërendimit e të informimit, ndërmjet institucioneve”, sipas teksteve përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GJENT IBRAHIMI

